



AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

**RAPORTI VJETOR MBI PUNËN E AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE
PËR VITIN 2019**

Shkup, 2020

PËRMBAJTJA

| | | |
|------------|--|------------------|
| 1. | <u>HYRJE</u> | <u>3</u> |
| 2. | <u>MENAXHIMI INSTITUCIONAL.....</u> | <u>4</u> |
| 2.1. | PUNA E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE | 4 |
| 2.2. | MISIONI DHE VIZIONI..... | 4 |
| 2.3. | VLERAT..... | 4 |
| 2.4. | STRATEGJIA PËR MENAXHIM ME RREZIQET | 5 |
| 2.5. | PLANIFIKIMI I PUNËS SË AMS-SË | 5 |
| 2.6. | AUDITIMI I BRENDSHËM | 5 |
| 2.7. | ORGANIZIMI DHE FINANCIMI I AMS-SË..... | 5 |
| 2.8. | PËRGJEGJËSIA KORPORATIVE SHOQËRORE | 5 |
| 3. | <u>AKTIVITETE TË REALIZUARA NË PERIUDHËN E RAPORTIT SIPAS FUSHAVE</u> | <u>6</u> |
| 3.1. | NORMATIVA DHE LICENCIMI | 6 |
| 3.2. | RREGULLORE TË MIRATUARA | 6 |
| 3.3. | LEJE DHE MIRATIME TË DHËNA | 7 |
| 3.4. | LICENCA TË DHËNA | 7 |
| 3.5. | LEJE DHE LICENCA TË REVOKUARA | 7 |
| 3.6. | TRAJNIME TË ORGANIZUARA..... | 8 |
| 4. | <u>ZBATIMI I MBIKËQYRJES.....</u> | <u>8</u> |
| 4.1. | MBIKËQYRJA NË TERREN..... | 8 |
| 4.2. | MBIKËQYRJA OFF-SITE | 8 |
| 5. | <u>KOMISIONET NË PUNËN E AMS-SË</u> | <u>8</u> |
| 5.1. | KOMISIONI PËR MARRËVESHJE DHE KOMISIONI PËR SHKELJET | 8 |
| 6. | <u>BASHKËPUNIMI</u> | <u>9</u> |
| 7. | <u>ORGANIZIMI I EVENIMENTEVE</u> | <u>9</u> |
| 8. | <u>EDUKIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE</u> | <u>10</u> |
| 9. | <u>MBROJTA E KONSUMATORËVE, EDUKIMI FINANCIAR DHE INKLUZIONI FINANCIAR.....</u> | <u>11</u> |
| 10. | <u>AKTIVITETE PROJEKTUESE</u> | <u>12</u> |
| 11. | <u>INFORMIMI I PUBLIKUT DHE TRANSPARENCA.....</u> | <u>13</u> |

1. Hyrje

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në **tekstin e mëtejshëm "AMS"**) është trup rregullator i pavarur i cili kryen autorizime publike, të përcaktuara me Ligjin për mbikëqyrje të sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 98/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 112/2011, 188/2013, 30/2014, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 198/2018) dhe ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019 dhe 31/2020), dhe me Ligjin për sigurim të obligueshëm në transport nr. 88/2005, 70/2006, 81/2008, 47/2011, 135/2011, 112/2014 dhe 145/2015 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/2019).

Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të veta AMS-ja kujdeset për ligjshmërinë dhe efikasitetin e tregut të sigurimit me qëllim që të mbrohen të drejtat e pronarëve dhe përdoruesve të sigurimit.

AMS-ja i ka këto kompetenca:

- Zbaton mbikëqyrje të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive për përfaqësim në sigurime, bankave të cilat kryejnë aktvitete të përfaqësimit në sigurime, brokerëve të sigurimit dhe përfaqësuesve në sigurime, të personave juridikë që lidhen me shoqëritë e sigurimeve dhe të Byrosë Nacionale për Sigurim;
- Miraton akte nënligjore për zbatim të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve dhe jep propozime për miratim të ligjeve nga fusha e sigurimit;
- Vendos për dhënien apo revokimin e lejeve, dhënien apo tërheqjen e pëlqimeve, dhënien apo marrjen e licencave;
- Shqipton masa të mbikëqyrjes;
- Bashkëpunon me institucionet dhe trupat relevantë të huaj dhe nga vendi dhe është anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve;
- E nxit zhvillimin e sigurimit dhe e zhvillon vetëdijen e opinionit mbi rolin e sigurimit dhe mbi rolin e supervizionit të sigurimit.

Duke u udhëhequr nga standardet, principet dhe parimet, midis të cilave janë edhe mbrojtja dhe informimi i të siguruarve mbi aktivitetet në suazat e fushëveprimit të vet në punë, AMS-ja ndërmerr një sërë aktivitetesh për përdoruesit e prodhimeve dhe shërbimeve të sigurimeve me qëllim që t'u mundësojë marrje në kohë të informacioneve të nevojshme.

Qëllimet themelore të AMS-së të cilat janë për stabilitetin dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve, dhe ndjekjen e ligjshmërisë së punës së subjekteve të cilat janë lëndë e mbikëqyrjes, lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorëve, përkatësisht të të siguruarve dhe përdoruesve të prodhimeve dhe shërbimeve të sigurimit.

AMS-ja për punën e vet mban përgjegjësi para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kuvendi i miraton: Planin financiar të AMS-së, Raportet financiare të rishqyrtuara nga një auditues i pavarur i autorizuar, Raportin vjetor për punën e AMS-së dhe Raportin vjetor mbi gjendjen dhe lëvizjen e tregut të sigurimeve.

2. Menaxhimi institucional

2.1. Puna e Këshillit të Ekspertëve

Organi i menaxhimit dhe udhëheqjes së AMS-së është Këshilli i Ekspertëve, i cili përbëhet nga Kryetari i Këshillit dhe katër anëtarë. Kryetari dhe katër anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të AMS-së i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 28 nëntor 2019, konstatoi se Klime Poposki, kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe anëtarit të Këshillit të Ekspertëve, Zllate Simonovski, u përfundon mandati.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 12 dhjetor 2019, mori Vendim për emërim të kryetarit dhe anëtarit të Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Në përputhje me këtë Vendim, Kuvendi i emëron:

- ❖ Kërste Shajnoskin, doktor të shkencave ekonomike, për kryetar të Këshillit të Ekspertëve me mandat prej pesë vjetësh, me orar të plotë pune, dhe
- ❖ Zllate Simonovskin, inxhinier i diplomuar për elektroteknikë, për anëtar profesional i angazhuar në Këshillin e Ekspertëve me mandat prej pesë vjetësh, me orar të plotë pune.

Përbërja e Këshillit të Ekspertëve:

- ❖ dr. Kërste Shajnoski, i angazhuar profesionalisht me orar të plotë pune, kryetar i Këshillit të Ekspertëve
- ❖ dr. Sulejman Ahmedi, anëtar i angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve, me orar të plotë pune,
- ❖ Zllate Simonovski, anëtar i angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve, me orar të plotë pune,
- ❖ dr. Igor Ivanovski, anëtar i Këshillit të Ekspertëve, i cili nuk është i angazhuar profesionalisht,
- ❖ Aleksandra Kokaroska, anëtare e Këshillit të Ekspertëve, e cila nuk është e angazhuar profesionalisht.

Këshilli i Ekspertëve është organ kolektiv i cili punon me seanca dhe merr vendime me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Gjatë vitit 2019 Këshilli i Ekspertëve në përputhje me Ligjin e mbikëqyrjes të sigurimeve, Statusin e AMS-së dhe Rregulloren e Punës së Këshillit të Ekspertëve, ka mbajtur rregullisht seanca ku ka vendosur për çështje në kompetencat e tij.

2.2. Misioni dhe vizioni

Misioni dhe vizioni i AMS-së synon krijimin dhe mbajtjen e një tregu transparent, të sigurt, stabil dhe të ndershëm të sigurimeve në dobi dhe në mbrojtje të të drejtave të të siguruarve, kontributin mbi rritjen ekonomike dhe sigurimin e stabilitetit të sistemit financiar.

2.3. Vlerat

Parimet dhe vlerat nga të cilat udhëhiqet AMS-ja janë: përgjegjësia, profesionalizmi, ndërgjegjësimi dhe transparenca.

2.4. Strategjia për menaxhim me rreziqet

Në vitin 2019 AMS-ja e miratoi Strategjinë për menaxhim me rreziqet për periudhën 2020-2022 si mjet që ndihmon të parashihen ngjarjet e papërshtatshme dhe të reagohet ndaj tyre, përkatësisht të jepen procedurat e kontrollit të brendshëm dhe resurset për funksionet kyçe dhe rreziqet që lidhen me to.

2.5. Planifikimi i punës së AMS-së

Me qëllim që të përcaktojë kornizën e punës së vet, në fund të vitit 2019 AMS-ja miratoi:

- Planin e punës për vitin 2020,
- Planin vjetor për mbikëqyrje në terren për vitin 2020,
- Planin financiar për vitin 2020,
- Plani për shenjat arkivuese dhe Listat e materialit dokumentues dhe lëndës arkivuese për vitin 2020.

2.6. Revizioni i brendshëm

Aktiviteti i revizionit të brendshëm në AMS, duke shfrytëzuar qasje sistematike, të disiplinuar dhe të bazuar në rreziqet, kontribuoi në përmirësimin e proceseve të udhëheqjes, menaxhimit me rrezikun dhe mbajtjen e kontrolleve efektive në ballafaqimin me rreziqet në menaxhimin, punën dhe sistemet informuese të AMS-së, në raport me:

- Realizimin e qëllimeve strategjike të AMS-së;
- Harmonizimin e ligjeve, dispozitave, procedurave dhe marrëveshjeve;
- Efektivitetin dhe efikasitetin e punës së programeve;
- Besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operative;
- Mbrojtjen e mjeteve.

2.7. Organizimi dhe financimi i AMS-së

Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të vendeve të punës, të punësuarit janë vendosur në 2 drejtori të pavarura që mbajnë përgjegjësi drejtpërdrejt para kryetarit dhe Këshillit të ekspertëve, 3 shërbime profesionale dhe 9 drejtori në suazat e shërbimeve profesionale.

Puna e AMS-së financohet nga kompensimet që i paguajnë shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime, shoqëritë për përfaqësim në sigurime, bankat të cilat kryejnë aktivitete të përfaqësimit në sigurime dhe personat e tjerë mbi të cilët AMS-ja kryen supervizion, të përcaktuara me Listën e Tarifave për përmbajtjen dhe vlerën e kompensimeve dhe detyrimeve që i paguhen Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe për afatet e pagimit, në përputhje me Ligjin për mbikëqyrje të sigurimeve.

2.8. Përgjegjësia korporative shoqërore

Në punën e vet AMS-ja i respekton parimet dhe principet e përgjegjësisë shoqërore korporative si përmlendhje të të gjitha pritjeve ekonomike, juridike, etike që shoqëria i ka ndaj subjekteve juridike. Në këtë drejtim, AMS-ja në vitin 2019 i ka ndërmarrë këto aktivitete:

- jep mundësi për punë praktike për nxënësit në arsimin e mesëm dhe për studentët,
- merr pjesë në aksione humanitare.

3. AKTIVITETE TË REALIZUARA NË PERIUDHËN E RAPORTIT SIPAS FUSHAVE

3.1. Normativa dhe licencimi

Në suazat e kompetencave në fushën e normativës dhe licencimit, AMS-ja në vitin 2019 i ka zbatuar këto aktivitete:

3.2. Rregullore të miratuara

1. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrje të licencës për përfaqësues
2. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrje të licencës për broker
3. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrje e lejeve në përputhje me Ligjin për mbikëqyrje të sigurimeve
4. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrje të lejes për kryerjen e punëve të përfaqësimit në sigurime
5. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrje të lejes për kryerjen e punëve të brokerimit në sigurime
6. Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kushtet për mbajtje të trajnimit dhe dhënies së provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime
7. Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kushtet për mbajtje të trajnimit dhe dhënies së provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime
8. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e fitim të pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqëri sigurimesh, shoqëri të brokerimit në sigurime dhe shoqëri për përfaqësim në sigurime
9. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores së llojeve dhe karakteristikave të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjionin matematikor, si dhe plasimin e detajuar dhe kufizimin e atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre
10. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare plotësuese të shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit
11. Rregullorja për investimin e mjeteve të provigjionit matematikor të cilat janë ndarë veçmas nga shoqëritë e sigurimit në bazë të marrëveshjeve për sigurim të jetës në lidhje me pjesëmarrje në fondet investuese kur i siguruari e ndërmerr rrezikun investues, mënyrën dhe afatet e informimit
12. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores së planit kontent të shoqërive për sigurime dhe risigurime
13. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare dhe përmbajtjen e detajuar të planit vjetor për punën e shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit
14. Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores së llojeve dhe përshkrimit të paragrafëve që do të merren parasysh gjatë llogaritjes së kapitalit të shoqatave të sigurimit dhe/ose risigurimit

15.Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për vërtetim të aktuarit të autorizuar

16.Rregullorja për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e pëlqimeve.

Ndryshimi i akteve nënligjore nga fusha e licencimit u zbatua për harmonizim të tyre me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimit, shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 198/2018, në pjesën e kushteve për marrjen e lejeve, pëlqimeve dhe licencave. Ndryshimet e Ligjit parashikojnë kushte shtesë për licencimin e aksionarëve - posedues të pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqëritë e sigurimit, aktuarët, përfaqësuesit dhe brokerët e sigurimit, të cilat janë vendosur në përmbajtjen e akteve nënligjore, kurse kanë të bëjnë me rregullimin e mënyrës, procedurës dhe dokumentacionit që jepet së bashku me kërkesën për marrjen e lejes, miratimit dhe licencës.

Ndryshimi i akteve nënligjore nga fusha e kontabilitet dhe informimit financiar të shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit ka për qëllim rregullimin e mënyrës së njohjes, evidentimit, matjes konsekuente dhe zbardhjes së paragrafëve të caktuar të raporteve financiare të shoqërive të sigurimit (tokë, objekte ndërtimore, mjete të tjera materiale dhe shpenzime për fitim) që nuk ishin lëndë e rregullimit në përmbajtjen e akteve ekzistuese. Me zbatimin e ndryshimeve mundësohet mënyrë konsistente e pranimit të shpenzimeve, të ardhurave, që lidhen me to, nga aktiviteti dhe si rrjedhim sigurimi i krahasimit të tyre në suazat e raporteve financiare të sektorit të sigurimeve si tërësi.

3.3. Leje dhe miratime të dhëna

- 11 leje për vendosjen e klasës së re të sigurimit;
- 4 leje për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime;
- 1 lejë për kryerjen e aktiviteteve për përfaqësim në sigurime;
- 24 miratime për ushtrim të funksionit anëtar në organ të menaxhimit;
- 16 miratime për ndryshim të Statutit të shoqërisë së sigurimeve;
- 18 miratime për shoqëritë për auditim të raporteve financiare dhe raporteve të konsoliduara financiare të shoqërive të sigurimit për vitin 2019;
- 1 miratim për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqërinë e sigurimit;
- 6 miratime për marrjen e pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqërinë e brokerimit të sigurimeve;
- 1 miratim për fitim të pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqëri për përfaqësim në sigurime;
- 3 miratime për bankë për ushtrim të aktiviteteve të përfaqësimit;
- 1 miratim për ndryshim të selisë së shoqërisë së sigurimeve;
- 2 miratime për ndryshim të emërimit të shoqërisë së sigurimeve.

3.4. Licenca të dhëna

- janë dhënë 53 licenca për brokerë sigurimi,
- 410 licenca për përfaqësues në sigurime.

3.5. Leje dhe licenca të marra

- I është marrë 1 leje për ushtrim të aktiviteteve brokere të sigurimit një shoqërie brokere të sigurimeve,
- përfundimi i dy lejeve, nga të cilat 1 për kryerjen e veprimtarive të brokerimit në sigurime dhe 1 për kryerjen e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime,
- është tërhequr një miratim për ushtrim të aktiviteteve të përfaqësimit në sigurimin në bankë, dhe

- u janë marrë 68 licenca për përfaqësues në sigurime personave fizikë.

3.6. Trajnime të organizuara

Për përforsimin e kapaciteteve për ndërmjetësim në tregun e sigurimeve, në vitin 2019 AMS-ja zbatoi dy cikle të trajnimeve për brokerë sigurimi dhe për përfaqësues në sigurim.

4. ZBATIMI I MBIKËQYRJES

AMS-ja zbaton mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të përfaqësimit në sigurime dhe Byrosë Nacionale për Sigurimet, në përputhje me Ligjin për mbikëqyrje në sigurime, Ligjin për sigurim të detyrueshëm në transport dhe dispozitave të tjera relevante. AMS-ja ka kompetencë të zbatojë supervizion edhe të personave fizikë të cilët ushtrojnë kativitete brokerimi në sigurime dhe aktivitete të përfaqësimit në sigurime.

Mbikëqyrja zbatohet nëpërmjet mbikëqyrjes permanente off-site të punës së shoqërive të sigurimeve dhe të subjekteve të tjera të sigurimeve nëpërmjet mbledhjes, analizimit dhe verifikimit të raporteve dhe informacioneve të dorëzuara, si edhe nëpërmjet mbikëqyrjes në terren (të tërësishëm apo të pjesshëm), mbikëqyrjes të punës së subjekteve të sigurimeve me qëllim që të vlerësohet siguria, stabiliteti, rrezikshmëria dhe harmonizimi i punës së subjekteve.

4.1. Mbikëqyrja në terren

Në përputhje me planin për mbikëqyrjen për vitin 2019, AMS-ja ka zbatuar 7 supervizione të pjesshme në terren të shoqëritë e sigurimeve. Në bazë të supervizioneve të zbatuara, AMS-ja ka shqiptuar 39 urdhëresa për eliminimin e paligjshmërive ndaj shoqërive të sigurimeve.

4.2. Mbikëqyrja off-site

Në bazë të gjetjeve nga zbatimi i mbikëqyrjes off-site, AMS-ja ka shqiptuar 11 urdhëresa për eliminimin e paligjshmërive dhe 8 masa plotësuese të mbikëqyrjes ndaj shoqërive të sigurimeve.

Nga të gjitha masat e shqiptuara të mbikëqyrjes, pjesa më e madhe e tyre janë për dobësitë e identifikuar në metodologjinë e përcaktimit të rezervave teknike, për evidencën jopërkatese të dëmeve dhe ndarjen e rezervimeve, mospërbajtjen ndaj rregullave për menaxhim me rrezikun, për mosrespektimin e standardeve minimale në sistemet informuese të shoqërive të sigurimeve, shkeljen e rregullave në profesionin e aktuarit.

5. KOMISIONET NË PUNËN E AMS-së

5.1. Komisioni për Marrëveshje dhe Komisioni për Shkeljet

Në vitin 2019 Komisioni për marrëveshje në AMS zbatoi 9 procedura për marrëveshje, gjatë të cilave janë arritur 9 marrëveshje për pagimin e gjobës.

Komisioni i Shkeljeve zbatoi një procedurë për shkelje gjatë shqiptimit të sanksionit të shkeljes.

6. BASHKËPUNIMI

Kryerja e punëve në kompetencë të AMS-së kërkon bashkëpunim me organet dhe institucionet vendase kompetente, me institucionet rajonale dhe ndërkombëtare rregullatore. Në drejtim të mbajtjes së tregut të qëndrueshëm, të ndershëm dhe transparent, AMS-ja e përforcon vazhdimisht edhe thellimin e bashkëpunimit me rregullatorët e tjerë në tregun vendas, në rajon dhe në Bashkimin Evropian.

Përforcimi i bashkëpunimit midis rregullatorëve vendas është i rëndësishëm dhe lidhet me shkëmbimin dhe përdorimin e informacioneve dhe të dhënave, sigurimin e trajnimit të përbashkët dhe shkëmbimin e përvojave. Bashkëpunimi me Sektorin për Sistemin Financiar në Ministrinë e Financave zhvillohet për çështje mbi normativën nga fusha e sigurimit. Bashkëpunimi me Bankën Kombëtare zhvillohet në suazat e shkëmbimit të të dhënave për përpilim të raportit mbi stabilitetin financiar, edukimin financiar dhe inkluzionin financiar, si dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të përvojës dhe praktikave në procesin e zbatimit të supervizionit.

Në drejtim të harmonizimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, ASM-ja bashkëpunon me Sekretariatit për Çështje Ekonomike duke dhënë të dhëna mbi procesin e tregut të sigurimit me qëllim të përgatitjes së raporteve mbi përparimin e shtetit në fushën e tregut dhe konkurrencës së brendshme dhe mbi çështjet ekonomike-financiare dhe statistikën, për nevojat e Nënkomiteteve të Bashkimit Evropian.

7. ORGANIZIMI I EVENIMENTEVE

Më 4 nëntor 2019, AMS-ja organizoi festim solemn të 10-vjetorit jubilar të ekzistimit dhe punës solide dhe njëkohësisht e shënoi Ditën e Sigurimit, 1 Nëntorin. Evenimenti është organizuar në dy pjesë. Në suazat e pjesës solemne, kishte njëkohësisht fjalim hyrës si nga AMS-ja ashtu edhe nga përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në suazat e evenimentit, kurse me qëllim të vërtetimit të bashkëpunimit të mirë afarist, AMS-ja u ka dhënë mirënjohje shumë institucioneve relevante dhe individëve të shquar. Është dhënë çmimi dhe plaketa për punimin më të mirë investigues nga fusha e menaxhimit me rreziqet dhe sigurimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019. Pas dhënies së çmimit, të pranishmit kishin mundësi që të njihen nga vetë autori i punimit me mesazhet kyçe të punimit shkencor.

Në suazat e pjesës së punës në këtë eveniment u mbajt një panel diskutimi me temë “Faktorët lëvizës për zhvillim më të lartë dhe të qëndrueshëm në sigurim në rajonin e Evropës Juglindore”, ku morën pjesë përfaqësues të AMS-së, përfaqësues të trupave rregullatorë nga rajoni, përfaqësues nga industria e sigurimit, profesorë, përfaqësues të shoqatave të siguruesve dhe ndërmjetësve në sigurime.

Në koordinim me SC XPRIMM International nga Bukureshti, Rumania (promotor i tregjeve të sigurimit dhe risigurimit), AMS-ja organizoi një konferencë rajonale aktuale në Shkup me temë siguri gjithëpërfshirës (Inclusive insurance), që nënkupton akses dhe përdorim të prodhimeve të thjeshta dhe të pranueshme të sigurimeve për klientët që nuk janë në akses të mjaftueshëm, me

theks të veçantë mbi kategoritë e prekura të qytetarëve, kurse para së gjithash për popullatën me të ardhura të ulëta.

Në bashkëpunim me Odën Ekonomike në drejtim të zhvillimit të tregut të sigurimeve, janë organizuar këto evenimente:

- Punëtori për përfaqësuesit e industrisë së sigurimit me temë zhvillim dhe zbatim i teknologjisë informatike në sektorin e sigurimit dhe standardeve dhe praktikave të supervizionit, në nivel nacional dhe nivel të Bashkimit Evropian.
- Eveniment Insurtek për startup kompanitë në vend dhe në vendet e Evropës Juglindore me qëllim të prezantimit të ideve dhe zgjidhjeve për digjitalizim të proceseve të punës së subjekteve të sigurimit.
- Hakaton për popullatën e studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, të cilët punojnë pas programeve arsimore në fushat e teknologjisë informatike në drejtim të promovimit të frymës të sipërmarrjes të rinjtë.
- Punëtori për përfaqësuesit e industrisë të sigurimeve me temë Përpilim i drejtpërdrejtë i dëmeve i autopërgjegjesisë.

Në shtator, AMS-ja ishte organizatore e Seminarit rajonal me temë: Digjitalizimi, supervizioni grupor dhe sjellja e tregut. Seminari është zbatuar në koordinim me Institutin për Stabilitet Financiar (ISF) dhe Asociacionin Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS) dhe ai u dedikohet trupave rregullatorë dhe institucioneve relevante nga rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore dhe vendet e Rajonit Transkaukaz.

Me qëllim të nxitjes së zhvillimit të sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kontributit në rritjen e numrit dhe cilësisë së punimeve shkencore të zbatuara nga fusha e menaxhimit me rreziqet dhe sigurimin, AMS-ja shpalli Konkurs për dhënien e çmimit vjetor për punimin hulumtues nga fusha e menaxhimit me rreziqet dhe sigurimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019. Si punimi më i mirë ishte shpallur punimi me titull “Kërkesa për sigurim të jetës dhe kufizimet gjatë huazimit” i autorit Bojan Sërbinoskit dhe i është dhënë shpërblim me të holla autorit në shumë prej 30.000 denarësh.

Në drejtim të ngritjes së vetëdijes së të rinjve mbi rëndësinë dhe rolin e sigurimit, në shtator të vitit 2019, AMS-ja shpalli Konkurs për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm me rastin e Ditës së Sigurimit – 1 Nëntor, me tema “Sigurimi dhe unë” për përzgjedhjen e krijimit më të mirë artistik – vizatim dhe krijimit më të mirë letrar – vjershë për nxënësit e arsimit fillor, dhe “Jeta është plot me surpriza, sigurimi është mbrojtja dhe siguria ime financiare” për përzgjedhjen e krijimit më të mirë letrar – tregim, për nxënësit e arsimit të mesëm. Janë dhënë 9 shpërblime me të holla (6 shpërblime me nga 3.000,00 denarë për nxënësit e arsimit fillor për krijimin më të mirë – vizatim dhe 3 shpërblime me nga 6.000,00 denarë për nxënësit e arsimit të mesëm për krijimin më të mirë – tregim).

8. EDUKIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Aftësimi i kuadrit të AMS-së është parakusht për kryerjen cilësore, efikase dhe në kohë të punëve dhe detyrave nën kompetencë të saj. Në vitin 2019, në përputhje me programet dhe nevojat e të punësuarve, u realizuan dhe zbatuan punëtori të llojit të trajnimeve të brendshme, shfrytëzimit të ekspertëve të jashtëm, vizita studimore, pjesëmarrje në seminare, përsosje profesionale,

konferenca, trajnime të ekipit, punëtori. Nga të punësuarit në AMS janë ndjekur programe edukative dhe trajnime të Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizionit të Sigurimeve (IAIS), Trupi Evropian për Supervizion (EIOPA), Banka për Rregullim Ndërkombëtar (BIS), Rrjeti Ndërkombëtar për Arsim Financiar dhe Edukim (OECD-INFE) dhe institucione dhe organizata të tjera relevante.

Në suazat e bashkëpunimit rajonal përfaqësuesit e AMS-së morën pjesë në punën e kolegjit të supervizionit tek institucionet rregullatore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: në Austri, Bullgari dhe në Slloveni. Kolegjet e supervizionit organizohen nga trupat rregullatorë të Bashkimit Evropian, në përputhje me drejtimet e Trupit Evropian për Sigurim dhe Fonde Evropiane (EIOPA), me qëllim të mbikëqyrjes më të mirë të grupacioneve të sigurimit në të cilat janë të pranishme shumica e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve të cilat janë në faza të ndryshme në proceset e aderimit në Bashkimin Evropian dhe përfaqësojnë platforma për shkëmbim të përvojave dhe zbatimit uniform të metodologjive.

AMS-ja si anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS) mori pjesë në punën e grupeve të punës së këtij trupi. Aktivitetet e AMS-së u realizuan me pjesëmarrje nëpërmjet studimeve hulumtuese dhe seminareve në organizim të Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve, pjesëmarrje në punën e Forumit të Supervizorëve si trupi më i lartë i punës dhe pjesëmarrje në konferencën vjetore.

Gjithashtu, AMS-ja, si anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar për Edukim financiar në Organizatën e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OECD-INFE) nga viti 2015, mori pjesë në punën e këtij trupi. Aktivitetet e AMS-së u realizuan kryesisht nëpërmjet qasjes të të dhënave dhe informacionet e dobishme për mbrojtjen e të siguruarve, për edukimin financiar dhe inkluzionin.

Me përfaqësuesit e vet AMS-ja mori pjesë në forumin e parë të supervizorëve të sigurimeve që u mbajt në shtator 2019 në selinë e Trupit Evropian rregullator për Sigurime dhe Pensione (EIOPA) në Frankfurt, Gjermani, ku morën pjesë përfaqësues nga EIOPA, Komisioni Evropian dhe trupat rregullatorë për sigurimet nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Në suazat e forumit u diskutuan sfidat në zbatimin e direktivave evropiane të sigurimeve në legjislacionet nacionale të vendeve nga Ballkani Perëndimor, përforcimi i dialogut midis trupave rregullatorë nga rajoni dhe EIOPA-ja, si edhe përforcimi i kapaciteteve të supervizorëve dhe praktikat për stabilitet më të madh në sektorin e sigurimeve.

Në drejtim të zmadhimit të efikasitetit të funksionit të supervizorit, AMS-ja nënshkroi Memorandum për bashkëpunim me Drejtorinë për Zbulim Financiar me qëllim që të përforcohet lufta për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

9. MBROJTA E KONSUMATORËVE, EDUKIMI FINANCIAR DHE INKLUZIONI FINANCIAR

Në përputhje me Ligjin për supervizionin e sigurimeve, një nga kompetencat e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit është zbatimi i aktiviteteve për mbrojtjen e të siguruarve, edukimi financiar dhe inkluzioni. Qëllimi përfundimtar është zmadhimi i nivelit të shkrim-leximit financiar i popullatës, duke kontribuar për të mirën e individit, të mirën e përgjithshme dhe ekonominë në shtet. Këto aktivitetet AMS-ja i realizon në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtare të Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS), Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Ekonomik (OECD), Grupin e 20 Ministrave dhe Guvernatorëve të Bankave Qendrore (G20) dhe organizatave dhe institucioneve të tjera relevante ndërkombëtare.

Në suazat e AMS-së punohet vazhdimisht mbi zbatimin e këtyre aktiviteteve:

- Nxit bashkëpunim midis institucioneve kompetente rregullatore në tregun financiar në fushën e edukimit financiar;
- Ngre iniciativa të Ministrisë së Arsimit dhe Byrosë për Zhvillim të Arsimit për të miratuar politika të cilat do ta mbështesin idenë për edukim financiar në vendin tonë;
- Bashkëpunon me institucionet arsimore (shkollat fillore dhe të mesme, fakultetet, institucionet etj.);
- Merr pjesë në përpilimin e Strategjisë Nacionale për Edukim Financiar nëpërmjet Trupit Koordinues të Institucioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në suazat e ndihmës teknike të siguruar nga Holanda (projekt që nisi në shtator të vitit 2018 dhe do të zgjasë 5 vjet);
- Merr pjesë në organizimin, zbatimin dhe vlerësimin e anketave mbi nivelin e edukimit financiar;
- Merr pjesë në takimet, punëtoritë dhe seminarët dhe llojet e tjera të trajnimeve;
- Promovon bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar në sferën e edukimit financiar.

Në mars të vitit 2019 AMS-ja, së bashku me anëtarët e Trupit Koordinues për Edukim Financiar dhe Inkluzion Financiar e shënoi Javën Globale të Parave nëpërmjet shumë aktiviteteve. Hapësirat e AMS-së ishin të hapura për nxënësit dhe studentët nëpërmjet prezantimeve edukative që të njihen me kompetencat e AMS-së. Çdo nxënës i është dhënë nga një kopje nga loja edukative e AMS-së me titull “Më pak rrezik, më tepër argëtim”. Janë organizuar edhe vizita në shoqëritë e sigurimeve me qëllim që të njihen me rolin e shoqërive të sigurimeve dhe me punën e tyre në tregun e sigurimeve.

AMS-ja mori pjesë në evenimentin nacional “Ditët e edukimit financiar” dedikuar publikut dhe ngritjes së vetëdijes për edukimin financiar.

Për mbrojtjen e të drejtave të të siguruarve dhe përdoruesve të prodhimeve dhe shërbimeve të sigurimeve, AMS-ja ka vepruar për ankimimet e marra kundër subjekteve të sigurimeve. Në vitin 2019 në AMS-ja janë dorëzuar 96 ankimime, prej të cilave:

- 73 ankimime janë zgjidhur, prej të cilave 27 në dobi të dorëzuesve të ankimimeve;
- 9 ankimime janë pa bazë për të vepruar;
- 14 ankimime janë në procesin e zgjidhjes.

10. AKTIVITETE TË PROJEKTIT

Gjatë vitit 2019 AMS-ja e realizoi Pilot-projektin me Shkollën e Mesme Ekonomike dhe Juridike të Qytetit të Shkupit “Vasil Antevski Dren”, i cili filloi në vitin 2018. Ky pilot-projekt u zbatua në një paralele prej 40 nxënësish nga viti i katërt në vitin shkollor 2018/2019, në disa faza. Faza e parë ishte njohja e nxënësve me materialin nga fusha e sigurimeve nëpërmjet prezantimeve të përshtatura me moshën e nxënësve. Janë prezantuar më shumë tema: rreziqe, terme të sigurimit (sigurimi i jetës dhe sigurimi jo-jetë), normativa ligjore në fushën e sigurimeve, kompetencat e AMS-së, të drejtat dhe obligimet e të siguruarve si konsumatorë të prodhimeve dhe shërbimeve të sigurimit, aktuarët

dhe roli i tyre, ndërmjetësimi në sigurimet, mbrojtja e interesave të konsumatorëve në sigurim. Faza e dytë ishte kontrolli i njohurive të fituara nëpërmjet testeve të shkurtra përkatëse, ishin organizuar vizita të trupave rregullatorë nga sistemi financiar dhe shoqatat e sigurimit. Faza e tretë në suazat e këtij projekti për edukim financiar ishte organizimi i garës – kuizit për nxënësit si shpërblim për mundin dhe përkushtimin e tyre në suazat e ciklit edukativ. Kuizi u zbatua në shkollë, kurse për qëllimin e tij ishte përgatitur test në bazë të materialit i cili u ishte prezantuar nxënësve gjatë mësimdhënies. Dy nxënësve më të mirë të AMS-së u janë dhënë dy shpërblime, me të cilat u është mundësuar trajnim pa pagesë dhe provimi për përfaqësues në sigurime.

Në gjysmën e parë të vitit 2019 AMS-ja me përfaqësuesit e vet mori pjesëmarrje në aktivitetin projektues për vlerësim nacional të rrezikut, në segmentin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ky aktivitet është zhvilluar në koordinim me Drejtorinë e Zbulimit Financiar. AMS-ja si rregullator i tregut të sigurimeve dha mbështetje dhe kontribut në përgatitjen e Raportit për azhurnimin e zbatuar të Vlerësimit Nacional të rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

Në suazat e projektit pesëvjeçar për edukim financiar (2018-2022) me mbështetje të Minsitrisë së Financave të Holandës dhe Rrjetit Ndërkombëtar për Edukim Financiar në OECD (INFE OECD), AMS-ja me përfaqësuesit e vet mori pjesë në takimin e punës në Bankën Nacionale të Gjeorgjisë me temë Përparimi i edukimit financiar në Evropën Juglindore. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të tjerë nga trupat rregullatorë vendas – anëtarë të Trupit Koordinues për Edukim dhe Inkluzion Financiar. Fokusi ishte mbi temat institucionale, konceptet dhe çështjet që lidhen me zbatimin e strategjisë nacionale për arsim financiar me qëllim që të shkëmbehen përvoja dhe njohuri, shkëmbehen analiza të hulumtimeve nga fusha e edukimit dhe inkluzionit financiar të OECD-së, njohja me sfidat në këtë fushë, planifikimi i aktiviteteve të ardhshme në suazat e një projekti afatmesëm. Është organizuar punëtori me fokus në përpilimin e studimit të rastit dhe politikës për ballafaqim me sfidat e edukimit financiar dhe edukimit të popullatës së re (nxënës dhe studentë), popullatës rurale, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

11. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE TRANSPARENCA

Në bazë të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010, 42/2014, 148/2015, 55/2016 dhe 64/2018), në AMS janë dorëzuar dy kërkesa për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik dhe u është dhënë përgjigje pozitive në afatin e përcaktuar ligjor.

Në bazë të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 196 më 10.11.2015) në AMS nuk janë dorëzuar fletëparaqitje për denoncues.

Në drejtim të dhënies në kohë të informacioneve dhe përforcimit të komunikimit me palët e interesuara, AMS-ja ka zbatuar ridizajnim të ueb-faqes së vet dhe krijoi një faqe të re edukative në internet për mbrojtjen e të siguruarve dhe për edukimin financiar me qëllim që të ofrojë përmbajtje të dobishme për konsumatorët financiarë, të siguruarit, investitorët, që të kuptojnë më mirë prodhimet e sigurimeve, konceptet dhe rreziqet, nëpërmjet marrjes të informacioneve në kohë, marrjes së këshillave objektive për zhvillim të mjeshtrive të tyre dhe besimit në marrjen e vendimeve financiare.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMIT

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve

dr. Kërste Shajnoski

Numër 01-395/1

Shkup

19.06.2020